



REPUBLIKA E KOSOVËS
KRYETARI I KOMUNËS SË SHTIMES



Nr. 02/641

Datë: 18. 11. 2020

Duke u bazuar në nenin 17 pika (a) dhe (c), dhe nenin 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040; Nenin 4 dhe nenin 8 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092; Nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi Komunës së Shtimes, si dhe Planin Zhvillimor Komunal 2009 – 2020, Kuvendi Komunës së Shtimes, mori këtë:

PROPOZIM-VENDIM

**PROPOZIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTË
PRONËN KOMUNALE**

I

Kryetari i Komunës me shkresën Nr.02/641, datë: 18. 10. 2020, i propozon Kuvendit të Komunës së Shtimes miratimin e Vendimit paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë pronën Komunale, si vijon:

- 1. Prona e pa lujtshme e Komunës te Vendi i quajtur “Gështenja”, Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809093-02270-4; Me sipërfaqe 33220m²; Zona Kadastrale – Shtime; Kultura – Kullosë e klasit të 3; Evidentuar, “Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime”. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim është 15 vite.**

II

A r s y e t i m: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtë, të pronave të paluajtshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes janë: Të mundësoj implementimin e planeve komunale si: Realizimin e Planit Zhvillimor Komunal 2009 – 2020, Përkrahjen e bizneseve vendore. Do të ndikojë pozitivisht në: Punësim, Investime, Shtimin e numrit të bizneseve, Rritje e numrit të taksapaguesve, Zhvillim ekonomik, dhe të hyra për Komunën.

III

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtë, do të kryhet duke u bazuar në ligjet pozitive si dhe përmes konkurrencës së hapur, Ankandit Publik.

Kryetari i Komunës
Naim Ismajli